



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:143905

Datë: 02.10.2024

Numri i dokumentit: 06243735

**2024:147892**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, si gjykatë e shkallës së parë penale, e përbërë nga gjyqtarja e vetme gjyquese Fitore Daci me bashkëpunëtoren profesionale Lavdije Brahimi-Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit N.H, me vendbanim në rrugën "...", rrugica ".....", numër , Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale, në vazhdim, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314, paragrafi 1, lidhur me nenin 77, të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.Nr.450/24 të datës 23.05.2024, duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me numër Nd.Nr....., të datës 17.09.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, në mes të pandehurit N.H, në njërën anë dhe të dëmtuarës KEDS SH.A, Ferizaj, të cilën e përfaqëson T.K në anën tjetër, konform nenit 357 paragrafi 1 nën par. 1. 3 të KPPK-së, si dhe nenit 15 paragrafi 1, të Ligjit për Ndërmjetësim, Nr.06/L-009, më datë 25.09.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- **APROVOHET**, marrëveshja Nd.Nr....., e datës 17.09.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, në mes të pandehurit N.H në njërën anë dhe të dëmtuarës KEDS SH.A, të cilën e përfaqëson T.K në anën tjetër.
- **HUDHET**, Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.Nr.450/24, e datës 23.05.2024 dhe
- **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurit N.H , për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

## **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me datë 23.05.2024, ka ngritur Aktakuzën PP/II.Nr.450/24, kundër të pandehurit N.H, me vendbanim në rrugën "...", rrugica ".....", numër , për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Duke vepruar konform nenit 9.5 dhe 9.6 të Ligjit për Ndërmjetësim, në seancën e datës 17.09.2024, me pëlqimin e palëve procedurale, u vendos që lënda penale të dërgohet në Qendër për Ndërmjetësim në Ferizaj ku është arritur marrëveshja Nd.Nr....., në mes të pandehurit N.H, në njërën anë dhe të dëmtuarës KEDS SH.A, të cilën e përfaqëson T.K në anën tjetër.

Palët e lartcekura në këtë çështje penale gjatë seancës së ndërmjetësimit u pajtuan që ta mbyllin si rast dhe të heqin dorë nga të gjitha procedurat penale dhe lënda të mbyllet me marrëveshjen e ndërmjetësimit.

Gjykata Themelore në Ferizaj, pas shikimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim, konstatoi se palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje penale të zgjidhet me ndërmjetësim dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes së ndërmjetësimit, vendosi që ta aprovoj marrëveshjen si të bazuar.

Konform Ligjit për Ndërmjetësim, Numër 06-L-009, neni 15, paragrafi 1, në datën e aprovimit nga gjykata përkatësisht nga data 25.09.2024, do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 357 par. 1 pika 1.3 të KPPK-së, si dhe nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**  
**2024:147892, datë 25.09.2024**

**Bashkëpunëtore profesionale**

**Lavdiye Brahimi-Aliu**

**Gjyqtarja**

**Fitore Daci**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3/tri/ ditëve, nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.